

A e dini?

- Çdo vit, PPO trajton mijëra **ankesa, përfshi ato nga të ndaluarit e imigracionit.**
- Në përgjigje të këtyre ankesave, PPO ju ka bërë pothuaj një mijë **rekomandime burgjeve dhe qendrave të largimit të imigracionit** gjatë vitit të fundit.
- Rezultatet e hetimeve tona e bëjnë ndalimin për shkak të imigracionit një vend **më të drejtë e më të sigurt** për të ndaluarit në të gjithë vendin.

“Unë dhe jam i sigurt që shumë të burgosur të tjerë, janë me fat që kemi një organ të pavarur të cilit mund t’i drejtohem për ndihmë. Ju faleminderit.”

Ankuesi A,
Burgu i Shkëlqesisë së Saj në
Northumberland

Të vërtetën rreth PPO

- Ne nuk punojmë për Ministrinë e Brendshme, ne nuk punojmë për Zbatimin e Imigracionit. PPO është **krejtësisht i pavarur.**
- Ankesat tuaja që na drejtoni **nuk do të lexohen nga Qendra e Ndalimit** dhe nuk do të përdoren kundër jush.
- Ne marrim mijëra ankesa çdo vit. **Ne DO TA marrim tuajën.**
- Nëse jemi dakord me ju, mund të merrni një **falje; t’ju mbulohe** **humbjet; apo edhe të bëhet një ndryshim në mënyrën se si funksionon qendra.**
- Ne synojmë që t’i përgjigjemi ankesës tuaj **brenda 10 ditësh** pasi ta kemi marrë.

Për çfarë mund të
ankohem?

Për çfarë mund të ankoheni?

Mund të ankoheni te PPO rreth çdo lloj çështjeje – që nga mënyra se si ju trajton personeli deri te sendet tuaja të humbura.

Por, ka disa gjëra të cilat nuk mund t’i hetojmë:

- Çështjen tuaj të imigracionit.
- Ankesat rreth kujdesit mjekësor.
- Si rregull i përgjithshëm, nëse kanë kaluar më gjatë se 3 muaj që nga përgjigja përfundimtare nga qendra e largimeve të imigracionit rreth ankesës tuaj fillestare.
- Ankesa duhet të jetë rreth diçkaje që ju ka ndodhur ju, jo dikujt tjetër.

Si të ankoheni

Si të ankohem
te PPO?

Sigurohuni që të ndiqni tre hapat e thjeshtë. Nëse nuk i ndiqni, ata nuk mund të hetojnë.

- 1** Sigurohuni që fillimisht të kaloni nëpër të gjithë procesin e ankesave të qendrës së largimeve të imigracionit.
- 2** Shkruani një shënim të shkurtër për të na thënë se për çfarë është ankesa juaj dhe përse nuk jeni ende të kënaqur.
- 3** Dërgoni gjithë dokumentet tuaja te ne – përfshirë gjithë formularët e ankesave të qendrës së largimeve të imigracionit.

Ku ta dërgoni ankesën tuaj

Ku t'i dërgoj të gjitha dokumentet e mia?

Dërgojini të gjithë dokumentet e ankesës tuaj te kjo adresë:

Prisons and Probation Ombudsman
PO Box 70769
London
SE1P 4XY

Letrat që i dërgoni Avokatit të Popullit janë pa pagesë.

"Ju falënderoj për gjithë kohën dhe përpjekjet që i keni kushtuar hetimit tuaj, e vlerësoj shumë."

*Ankuesi B,
Burgu i Shkëlqesisë së Saj në
Kennet*

Prisons &
Probation
Ombudsman
Independent Investigations

Si të ankoheni tek Avokati i popullit

